



PSH.nr.849/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenkovic - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Uni - Care” SH.P.K. - Prishtinë, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19”, me numër të prokurimit 616-20-5738-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, më datën: 23.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Uni - Care” SH.P.K. - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19”, me numër të prokurimit: 616-20-5738-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë.

II. OBLIGOHET, autoriteti kontraktues /Komuna e Prishtinës /, ti bëj ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit në pajtim me dispozitat ligjore dhe të zgjasë afatin për ofertë duke vepruar konform nenit 53.7 të LPP-së, dhe të marrë parasysh rekomandimet e dhëna në raportin e ekspertizës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19”, me numër të prokurimit: 616-20-5738-1-1-1.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Uni - Care” SH.P.K. - Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues “Uni - Care” SH.P.K. - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 23.10.2020 me nr. 849/20, kundër njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim emergjent me teste serologjike për SARS-COVID-19”, me numër të prokurimit: 616-20-5738-1-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 05.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr. 849/20 është se:

“...Në njoftimin për kontratë AK ka specifikuar teste serologjike të vetëm një prodhuesi gjë që pamundëson ofertimin apo pjesëmarrjen e OE-ve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit të cilët gëzojnë të drejtën e reprezentimit të prodhuesve të tjerë...”

Ky pretendim i OE ankues vlerësojmë se është i bazuar, ndërsa arsyetimi i AK-së lidhur me këtë çështje (në sqarimet e dhëna nga AK me 06.10.2020) ka qenë se:

“I nderuar, ju falemnderit për shkresën! Sa për informatën tuaj do ju jap disa sqarime shtesë sa i përket barazisë së operatorëve ekonomik. Komuna e Prishtinës i ka dy lloje të aparaturave për teste aerologjike:

1. Vidas PC.

2. Chorus ,

të cilat në kohën më të rëndë për ne si popull dhe në veçanti si kryeqytet, operator ekonomik na sjellën 4 aparate falas andaj ne i kemi këto aparate në shfrytëzim dhe nuk mund të kërkojmë lloje të tjera të testeve me

hamendësim pa pasur aparaturë në disponim sepse janë me dhjetëra aparatura të cilat realizojnë teste serologjike. Ju ftoj që ofertën tuaj për dhënie donacion të aparaturës dhe prezantimin e specifikave dhe katalogëve të caktoni një takim në kabinetin e kryetarit dhe të na tregoni për përparësitë dhe mangësitë e aparatit tuaj, gjithashtu edhe cost-benefitin për Komunën e Prishtinës dhe qytetarët e saj, edhe pse këto dy lloje me gjithsej katër aparate në katër QMF po i mbulojnë pa ndonjë problem, mirëpo duke mos e ditur se çka na sjell e ardhmja, oferta e juaj është e mirëseardhur për t'u analizuar. Sa i përket këtij tenderi, ju lutem ti referoheni dosjes së tenderit”.

Vlerësojmë se në rastin konkret janë krijuar rrethana favorizuese për një apo më shumë OE duke diskriminuar OE të tjerë ofertues potencial (si psh OE ankues). Nga kjo që u potencua më lart, duket se AK ka pranuar pajisjet në shfrytëzim falas nga OE, ndërsa tani pretendojnë se kjo i obligon të kërkojnë teste vetëm për ato pajisje ekzistuese. Vlerësojmë se kërkesa e OE ankues është e drejtë, dhe duhet lejuar edhe OE të tjerë (sikurse OE i parë) të ofrojnë pajisjet falas në shfrytëzim ndërsa fituesi të caktohet në bazë të cmimit të testeve.

Arsyetimi i AK-së se duhet shikuar Cost-Benefit për Komunën e Prishtinës (sa i përket pajisjeve tjera), vlerësojmë se Cost-Benefiti më së miri do të dihej përmes çmimeve të testeve nga OE-të, dhe pjesëmarrja më e gjerë e OE-ve sigurisht se do të krijonte konkurrencë dhe çmime më të favorshme për Komunën e Prishtinës. Andaj rekomandojmë që të bëhet shtyhet afati i ofertimit konform dispozitave të LPP-së dhe të bëhet korrigjimi i dosjes së tenderit duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të OE-ve në pajtim me dispozitat e nenit 7 LPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Më tej propozohet që të obligohet AK të bëjë korrigjimet sipas sqarimeve të dhëna më lartë dhe të bëhet zgjatja e afatit për ofertim konform dispozitave të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 09.11.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues, duke shtuar:

AK nuk pajtohet me mendimin e ekspertit, pasi që çështja e donacioneve për aparatura të testimit duhet të zgjidhet me lejim përkatës nga MSH, që do të thotë se ankuesi së pari duhet t'a rregulloj këtë çështje me ministrinë dhe pastaj mund të konkurroj në AK për furnizim me teste. AK edhe në vendimin për rishqyrtim ka cekur se në të ardhmen do të mirëpret aparaturat dhe testet më të avancuara, por për këtë veprim duhet së pari të sigurohet leja nga MSH. Bashkangjitur është pjesa e dokumentit zyrtar për aplikim në MSH.

Operatori Ekonomik nuk është deklaruar se a pajtohet apo nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 23.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues “Uni - Care” SH.P.K. – Prishtinë, se: “...Në njoftimin për kontratë AK ka specifikuar teste serologjike të vetëm një prodhuesi gjë që pamundëson ofertimin apo pjesëmarrjen e OE-ve të tjerë në këtë aktivitet të prokurimit të cilët gëzojnë të drejtën e reprezentimit të prodhuesve të tjerë...”

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është i bazuar, ndërsa arsyetimi i AK-së lidhur me këtë çështje (në sqarimet e dhëna nga AK me 06.10.2020) ka qenë se: “I nderuar, ju faleminderit për shkresën! Sa për informatën tuaj do ju jap disa sqarime shtesë sa i përket barazisë së operatorëve ekonomik. Komuna e Prishtinës i ka dy lloje të aparaturave për teste aerologjike: 1. Vidas PC, 2. Chorus, të cilat në kohën më të rëndë për ne si popull dhe në veçanti si kryeqytet, operator ekonomik na sjellën 4 aparate falas andaj ne i kemi këto aparate në shfrytëzim dhe nuk mund të kërkojmë lloje të tjera të testeve me hamendësim pa pasur aparaturë në disponim sepse janë me dhjetëra aparatura të cilat realizojnë teste serologjike. Ju ftoj që ofertën tuaj për dhënien donacion të aparaturës dhe prezantimin e specifikave dhe katalogëve të caktoni një takim në kabinetin e kryetarit dhe të na tregoni për përparësitë dhe mangësitë e aparatit tuaj, gjithashtu edhe cost-benefitin për Komunën e Prishtinës dhe qytetarët e saj, edhe pse këto dy lloje me gjithsej katër aparate në katër QMF po i mbulojnë pa ndonjë problem, mirëpo duke mos e ditur se çka na sjell e ardhmja, oferta e juaj është e mirëseardhur për t’u analizuar. Sa i përket këtij tenderi, ju lutem ti referoheni dosjes së tenderit”.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se në rastin konkret janë krijuar rrethana favorizuese për një apo më shumë OE duke diskriminuar OE të tjerë ofertues potencial (si p.sh. OE ankues). Nga kjo që u potencua më lart, duket se AK ka pranuar pajisjet në shfrytëzim falas nga OE, ndërsa tani pretendojnë se kjo i obligon të kërkojnë teste vetëm për ato pajisje ekzistuese. Vlerësojmë se kërkesa e OE ankues është e drejtë dhe duhet lejuar edhe OE të tjerë (sikurse OE i parë) të ofrojnë pajisjet falas në shfrytëzim ndërsa fituesi të caktohet në bazë të çmimit të testeve.

Arsyetimi i AK-së se duhet shikuar Cost-Benefit për Komunën e Prishtinës (sa i përket pajisjeve tjera), vlerësojmë se Cost-Benefiti më së miri do të dihej përmes çmimeve të testeve nga OE-të, dhe pjesëmarrja më e gjerë e OE-ve sigurisht se do të krijonte konkurrencë dhe çmime më të favorshme për Komunën e Prishtinës. Andaj, obligohet AK që të bëjë shtyrjen e afatit të ofertimit konform dispozitave të LPP-së dhe të bëhet korrigjimi i dosjes së tenderit duke mundësuar pjesëmarrje më të gjerë të OE-ve në pajtim me

dispozitat e nenit 7 LPP-së.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, si dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e përpilimit të dosjes së tenderit ka caktuar kërkesa të cilat do të ndikonin në reduktimin apo eliminimin e konkurrencës në kundërshtim me nenit 7 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që konform nenit 53.7 të LPP-së të zgjas afatin për ofertë dhe ti bëjë ndryshimet e nevojshme në dosje të tenderit dhe njëherit duke vepruar në pajtim me sqarimet e dhëna nga eksperti shqyrtues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimin të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK KK Prishtinë
- 1x1 OE "Uni - Care" SH.P.K. - Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.